



Komuna e Shtimës

Zyra e Prokurimit

Nr. 03191056

Datë 07/10/2020

KONTRATË PËR FURNIZIM

Komuna Shtime Rr. „Tahir Sinani „, tel. 0290-389-016-228 ,që e përfaqëson: Muhadin Halili ,
Drejtor i Prokurimit në njëren anë:

dhe

N.P. " MGA ", Emin Duraku,5, PRISHTINË ,që e përfaqëson ,z.Ahmet Govori
tel.044/126-342 në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publiko për

Blerja e gjeneratorit për shtëpinë rezidenciale

Numri i Prokurimit : 617-20-5246-1-3-6

Numri i Brendshëm i Prokurimit: 617-2020-065-136

Neni 1 Lënda

Lënda o kontratës do të jetë

Blerja e gjeneratorit për shtëpinë rezidenciale

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 12.10.2020 dhe përfundon me 07.12.2020

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë : Shtëpia Rezidenciale në Shtime

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë

Neni 3 Çmimi

**3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 4,370.00 €
(Katërmijë e treqindë e shtatëdhjetë euro)**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borbh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të dërgesës dhe raportit të pranimit të të Gjeneratorit ,nga pesoni i autorizuar ne Kontratë me afatë të liferimit 20 ditë

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për NA

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet të kryej ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është

nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *gjykatën kompetente* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqipe* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik


Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Ahmet Govori	Emri:	Muhadin Halili
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtor i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	07.10.2020	Data:	07.10.2020
Vula:		Vula:	

Specifikacioni-Bartja e gjeneratorit për shitëpia rozidoficiale

Nr	Artikulli	Njësia	sasia	cmimi eur	totali
1	<p>Specifikimet teknike për bartjen e gjeneratorit dizel 25 KVA PERSHKRIMI I MAKINES: Fuqia në punë (në gjendje qetësie) (KVA): 25KVA Fuqia (kw): 20KW Faktori i fuqisë 0,80 Tensioni: 400/230 volt Numri i rrotullimeve per minut: 1500min-1 Frekuenca: 50hz Sferi .pa zhurmë MOTORIMotori: dizel,4-Cilinder, ftohjen me ujë Sistemi guvernatorit mekanik,Sistemi i karburantit të drejtpërdrejtë INFORMATAT E MOTORIT: Numri i cilindrave: 4in line ,Pjerrësia e shpimit (mm) 90* 100, Sistemi i ftohjes: Uj i ftohur, Fuqia maksimale (kw) 20KW Sistemi operativ: 12vohi, Konsumi i karburantit (Ngarkesa e karburantit): 4L-8.4L/h SHASIA:Çelik i montuar Shasa çeliku elastike me motor dhe alternator Mbrojtës kundër vibrimit- amortizorët Funkcionim dhe largim i lehtë. KABINA: Bartja e lehtë si dhe dizajn lehtës Materiali i përdorshëm, i pa zhurmshëm .Izolimi kundër lagështisë ALTERNATORILoji i alternatorit pa brushë, Rregullator automatik i tensionit A.V.R sv 450, Klasa e izolimit H ,Mbrojtja: IP22 PANELI I KONTROLLIT: Panel kontrollues,Ampmetër,voltmetër,frekuencë pranues,Butoni i ndalimit emergjent DIMENSIONET DHE PESHAT:Max Loji i kabinit (gjatësia në largësi) 2100:900:1200mm. Të ketë aksesin e ngarkesës në 100% ngarkesë</p>	çop il	1	4370.00	4,370.00
				Totali	4370.e0

Emri i Kompanisë	NPMGA
Adresa e Postës	EMIN DURARU, 6
Përfunduar Nga:	
Emri & Mbetimi	AHMET GOVORI
Posta	DREJTOR
Nëshkrimi	
Data	21.09.2020
Vota	



AFATI I LIFERIMIT TE GJENERATORIT

Afati i liferimit te GJENERATORIT eshte 20 dite pas nenshkrimitt te kontrates.

Me nderime,

NPMGA

21.09.2020

